



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MIMOZA SADUHAJ  
ADRESA rruga Vaso Pasha, pallati 13/1  
Tirane  
TEL: 0692097547

# REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SH.P.K-VE

Nr. repertori: 1371

Nr. koleksioni: 495

Tirane më 03/04/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 10 fletë



A2021053540055449619



**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“MedOxy Albania” SH.P.K**

Sot, më datë 03.04.2021, përpara meje Notere MIMOZA SADUSHAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, rruga Vaso Pasha, pallati 13/1 Tirane, u paraqiten personalisht:

**THEMELUESIT:**

1. Ali Soydan, atësia Mustafa, shtetas Turk, lindur në Ipsala dhe banues në Turqi, lindur më 14/10/1965, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me pasaporte turke nr. U22504057 perfaqesuar me prokure te posacme me nr. 381 Rep dhe me nr. 105 Kol date 27.01.2021 noteruar nga notere Mimoza Sadushaj nga Armela Topi, atësia Llazar, shtetase shqiptare, lindur ne Durres, dhe banuese ne Tirane, e datelindjes 03.06.1992, madhore me zotesi te plote per te vepruar, per identitetin e te ciles u sigurova me leternjoftim nr. 036433725 dhe nr. personal J25603064N.
2. Anisa Ilia, atësia Pandeli, amësia Diana, shtetase Shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, me adresë 'frosina Plaku'; Nd. 40; H. 12; Ap. 9; Njësia Administrative Nr. 7; Njesia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 11/05/1989, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034683462 dhe nr. personal I95511109O,
3. Rubin Topi, atësia Flamur, amësia Shkëndie, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga Dibrës; Nd. Kat 10; H. Shk 2; Ap. Ap 37; Njësia Administrative Nr. 8; Njesia Bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë, lindur më 28/08/1981, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035113656 dhe nr. personal I10828074B .

te cilet kane vendosur te themelojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar “Medoxy Albania”shpk. Me vullnetin e tyre te lire hartojne Statutin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar MedOxy Albania, ne perputhje me Ligjin nr. Nr.9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, Ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, Ligji nr.131/2015”Per Qendren Kombetare te Biznesit”.


**KREU I**

**Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti**

**Neni 1**

**Emertimi**

Emertimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte “MedOxy Albania” shpk.



### **Forma Juridike**

Shoqeria “**MedOxy Albania**” shpk, është person juridik i të drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Shoqëria “**MedOxy Albania**” shpk, është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe ortakët përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të saj në kapitalin themeltar.

### **Neni 3**

#### **Selia**

Shoqëria e ka selinë në adresën: Rruga "Frosina Plaku", Kompleksi Magnet, Zyra 118, Kati 1, Kodi postar 1000.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

### **Neni 4**

#### **Objekti**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është: Tregtia e barnave dhe mallrave farmaceutike dhe furnizimi i subjekteve publik e privat, import-eksport i tyre, tregtia e lendeve të para për produkte farmaceutike, tregtia mallra kozmetike të kujdesit shëndetësor, mallra të ndryshëm të fushës shëndetësive, pajisje mjekësore etj. Kryerja e aktiviteteve ndihmëse për realizimin e qëllimit të aktiviteteve kryesore.

### **Neni 5**

#### **Kohezgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tyre për një periudhë kohore të pakufizuar.

## **KREU II**

## **KAPITALI**

### **Neni 6**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 leke.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga ortakët:

1. Z.Ali Soydan, zoterues i 1 kuote me vlerë nominale 5000 leke, që përben 50 % të kapitalit themeltar.
2. Znj.Anisa Ilia, zoteruese e 1 kuote me vlerë nominale 2500 leke, që përben 25 % të kapitalit themeltar.
3. Z.Rubin Topi, zoterues e 1 kuote me vlerë nominale 2500 leke, që përben 25% të kapitalit themeltar



Kontributi i ortakeve mund te jete ne para-ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta).

**Neni 7**

**Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga ortaket, te cilet marrin vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

**Neni 8**

**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerise me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- ç) dhurimit;
- d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Ky statut kushtezon kalimin e kuotave te treteve jashte shoqerise, me miratimin e shoqerise dhe te drejten e parablerjes ne favor te shoqerise apo te ortakeve te tjere, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te tyre ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te Ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

**KREU III**

**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

**Neni 9**

**Organi Vendimmarres**

Asambleja e Pergjithshme eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Te drejtat dhe detyrimet e Asamblese se Pergjithshme ushtrohen nga ortaket e shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;



- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike; dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Te gjitha vendimet e marra nga ortaket e shoqerise regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

#### **Neni 10**

#### **Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e te dergohet jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

#### **Neni 11**

#### **Kuorumi**

Ortaket e shoqerise kane rene dakord qe marrja e vendimeve te shoqerise , do te behet me votim unanim nga te gjithë ortaket e shoqerise. Vendimet qe nuk plotesojne kete kusht, do te jene te pavlefshme.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

#### **Neni 12**

#### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e pergjithshme vendos me miratimin e te gjithë ortakeve, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.



A2021053540055449619

Asambleja e pergjithshme vendos me miratimin e te gjithë ortakeve per çeshtje te tjera si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- ç) percaktimin e shperblimeve
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori/et , perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### **Neni 13 Administrimi**

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator .

Administrator i shoqerise eshte Znj.Anisa Ilia lindur më 11/05/1989, ne Vlore dhe banuese ne Tirane, Leternjoftim ID nr. 034683462 dhe nr. personal I955111090.

Administratori do te ushtroje detyrat e tij sipas statutit dhe ligjit per nje periudhe 5 vjecare me te drejte ripertesitje.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje Administratorin ne çdo kohe me shumice unanime te te gjithë ortakeve. Statuti, apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte. Perveç ketyre, Administratori/et shkarkohen nga gjykata per shkelje te ligjit me kerkese te çdonjerit prej ortakeve.

Tagrat e perfaqesimit te administratorit/eve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen per regjistrim prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Emerimi i administratorit/eve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person jashte ortakerise.

### **Neni 14 Kompetencat**

*Administratori/et kane te drejte e detyrohen te:*

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- ç) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;



A2021053540055449619

e) raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

Administratori/et jane te detyruar te therrasin asamblene e pergjithshme edhe ne rastet kur :

- asambleja e pergjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe

- kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te tyre, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te asetve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara,

Administratori/et kane te drejte te kryejne te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem. Administratori/et perfaqesojne Shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve. Administratori/et kane te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori/et angazhojne shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e tyre.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i

Administratorit/eve e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin/et ne çdo kohe me unanimitet te votave. Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## Neni 15 Pergjegjesite

Administratori/et jane pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit/eve dhe ortakut/ve qe kane bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;

b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

c) te vleresoje me pergjegjesi çeshtjet, per te cilat merret vendim;

ç) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;



d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

2. Administratori/et, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjen ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

### **Neni 16** **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

### **Neni 17** **Bilanci i shoqerise dhe dividendet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori/et.

Mbledhja e Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

### **Neni 18** **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollët periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollët periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

### **Neni 19**

Te ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi te ortakeve.

### **Neni 20** **Shperndarja e shoqerise**



Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e tyre;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- d) me vendim te gjykates;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emeratesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Asambleja e Ortakeve.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

#### Neni 21

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

Nese shoqeria emerom me shume se nje likuidues, perveçse kur akti i emerimit parashikon se ata veprojne veçmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojne bashkerisht te drejtat e detyrimet sipas ketij ligji. Likuiduesit mund te autorizojne njerin prej tyre te kryeje veprime te nje kategorie te posaçme. Kufizimet e tagrave te likuiduesve u kundrejtohen te treteve, ne perputhje me percaktimet e ligjit. Likuiduesi u nenshtrohet mbikeqyrjes se ortakut dhe administratorit/eve.

#### Neni 22

##### Te drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise, mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhen e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund te kryeje edhe veprime te reja tregtare, per mbylljen e nje veprimi te paperfunduar.
3. Nese, ne baze te padive te ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", likuiduesit verejne se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojne proceduren e likuidimit e t'i kerkojne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit.

Likuiduesi pergatit nje bilanc te gjendjes se shoqerise ne çastin e hapjes se likuidimit dhe nje bilanc perfundimtar ne çastin e mbylljes se ketyre procedurave. Nese procedura e likuidimit zgjat me shume se nje vit, likuiduesi pergatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore te shoqerise.

#### Neni 23

PERFUNDIMI I LIKUIDIMIT



Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon çregjistrimin e shoqerise, ne perputhje me seksionin V te Ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

**Neni 24**  
**Ndarja**

1. Nje shoqeri mund te ndahet me vendim te Asamblese se Ortakeve, duke transferuar te gjitha aktivet e pasivet e veta ne favor te dy ose me shume shoqerive ekzistuese apo te themeluara rishtazi. Shoqeria qe ndahet, vleresohet e prishur.
2. Per ndarjen e shoqerise zbatohen perkatesisht dispozitat e neneve 216 deri ne 225 te ligjit 9901 date 14.04.2008.
3. Regjistrimi i ndarjes se shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ka si pasoje:
  - a) kalimin te shoqerite pritesore te te gjitha aktiveve e pasiveve te shoqerise qe ndahet, ne perputhje me raportin e ndarjes, te percaktuar ne marreveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja per marredheniet ndermjet shoqerive, si dhe per palet e treta;
  - b) berjen e aksionareve/ortakeve te shoqerise qe ndahet aksionare apo ortake te nje ose me shume shoqerive pritesore, ne perputhje me raportin e ndarjes, percaktuar ne marreveshjen e ndarjes;
  - c) vleresimin e shoqerise qe ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e tyre nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, sipas seksionit V te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

**Neni 25**  
**Shnderrimi**

Shoqeria mund ta ndryshoje formen e vet ligjore, nepermjet shnderrimit te tyre ne shoqeri aksionare. Shnderrimi nuk sjell pasoja mbi te drejtat e detyrimet, qe shoqeria ka marre persiper ndaj te treteve.

**Neni 26**  
**Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.  
Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

**Neni 27**  
**Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

**Dispozita perfundimtare**



A2021053540055449619

Ky akt themelimi dhe statut u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket e shoqerise tregtare *MedOxy Albania* shpk, dhe nenshkruhet ne te gjitha kopjet.

Unë Noterja verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**THEMELUESIT**

ALI SOYDAN

perfaqesuar me prokure nga:

ARMELA TOPI *Armela Topi*

ANISA ILIA *Anisa Ilia*

RUBIN TOPI *Rubin Topi*

REPUBLIKA E SHQIPËS  
MINISTRIA E SHËNDESE  
DHE Mbrojtjes  
NOTERË  
MIMOZA SADUSHAJ  
TIRANË